



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI PORTUAL DURRËS

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “F/V Materiale reduksioneve i tubave te presioneve te larta” (*Procedurë e Hapur e thjeshtuar - Mall*)

VLERA E FONDIT LIMIT: 3.000.000 (tre milion) leke, **pa tvsh.**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- Reduktues-presioni, kontroll apo valvola të sigurisë 42131140-9

Afati i lëvrimit do jetë **12 (dymbëdhjetë) muaj** nga data e nënshkrimit të marrëveshjes kuadër.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor – Autoriteti Portual Durrës – ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*
- Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, i ndryshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (*sipas shtojcës 8*).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP-së i ndryshuar, nenin 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të realizuar për tre viteve e fundit financiare (2022-2023-2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit. *Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/c e 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % nga vlera e përllogaritur e fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të furnizimit e realizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të furnizimit e realizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, si dhe në nenin 40, pika 4 e 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar,

parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin Dokumentin e titulluar Ofertë Teknike të ngarkuar në SPE nga Autoriteti Kontraktor në formën e një tablele kërkesat e të cilit duhet të plotësohen rigorozisht nga Ofertuesi artikujt e Listës. Oferta teknike duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë:

- Emri i kompanisë prodhuese
- Emërtimi i Katalogut të prodhuesit ose i skedës teknike
- Numri i faqes në katalog ose në skedën teknike ku ndodhet artikulli
- Numri (kodi) identifikues i artikullit të ofruar, i shënuar me një shenjë dalluese

Të dhënat e deklaruara në ofertën teknike duhet të korespondojnë me të dhënat për artikujt në katalogët/skedat teknike të dorëzuara. Moskorespondimi i këtyre të dhënave do të sjellë pavlefshmëri të ofertës.

Argumentim: Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Kriteri i kerkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me piken 6, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2.3.3 Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kerkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve për listën e mallrave objekt prokurimi, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qarte materialet që do të ofrohen.

Shenim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qarte që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin.

Argumentim: Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Kriteri i kerkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me piken 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori zyrtar për TUBA PRESIONI sipas dokumentit “Lista e Materialeve” kjo e vërtetuar nepermjet dokumentave origjinal si perfaqesues i kompanise prodhuese per mallin/mallrat.

Në rast paraqitje Autorizimi Distributori, OE duhet te paraqesë ne leter angazhim ose Akt marreveshje midis prodhuesit dhe distributorit e vlefshme midis tyre, mbi të drejtat e furnizimit me llojin e mallit të ofruar ne Republiken e Shqiperise.

Argumentimi:

Autorizimi i prodhuesit ose distributorit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon kanalin zyrtar te origjinës së mallrave/licensimeve specifike që kërkohen në kete prokurim, garanton gjithashtu se ofertuesi është i autorizuar per territorin e Shqiperise për ofrimin tek AK të këtyre produkteve. Kjo garanton qe produktet që kërkohen të blihen janë prodhuar/krijuar sipas standardeve të larta nga prodhues të njohur zyrtarisht. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor per tu garantuar qe Operatori Ekonomik ka mbështetjen dhe suportin e prodhuesit per te garantuar cilesine e produkteve dhe furnizimin e tyre ne kohe për përmbushjen me sukses të kontratës, duke garantuar funksionimin e pajisjeve ne kushtet e garancisë dhe pas saj.

Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 5 dhe 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij të punësuar (per kete sherbim), të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme si dhe duhet të figurojnë në listpagesën e muajit të fundit:

1 (nje) punonjës inxhinier mekanik me pervoje pune jo me pak se 6 (gjashte) muaj

1 (nje) punonjes me detyre Drejtues teknik.

1 (nje) punonjes shofer mjeti dhe 3(tre) punonjes punonjes operativ

Ky kriter permbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021,I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është bazuar në paragrafin 3 të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për Stafin, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, specifikimet teknike, raportin teknik dhe volumet e punimeve. Numri është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e kontrates. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

2.3.6 Referuar objektit te procedures operatori ekonomik duhet te kete te paktën njerin prej punonjesve te trajnuar/certifikuar me ISO/IEC17020:2012 ose ekuivalent dhe ISO 45001:2018 ose

ekuivalent Për të dëshmuar plotësimin e këtij kriteri OE ofertues duhet të paraqesë certifikatën përkatës.

Ky kriter permbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është bazuar në paragrafin 3 të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për Stafin, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, specififikimet teknike, raportin teknik dhe volumet e punimeve. Numri është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e kontrates. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe paisjet e mëposhtme të cilat duhet të jenë në pronesi të tij ose me qira/ huapërdorje të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës:

Nr.	Përshkrimi i Mjetit/ pajisjes	Sasia
1.	Mjet transporti per te kryer sherbimin	Jo më pak se 1 copë
2.	MAKINERI PER KONFIGURIMIN E TUBAVE METALIK	Jo më pak se 1 copë
3.	MAKINERI PRESIMI 2"BF	Jo më pak se 1 copë
4.	PASTRUSE TUBI 200 BF	Jo më pak se 1 copë
5.	MAKINERI PRESIMI 2" 4SP	Jo më pak se 1 copë
6.	MAKINERI PERKULESE	Jo më pak se 1 copë
7.	MATES ANALOG GJATESIE METALIK	Jo më pak se 1 copë

Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për mjetet dhe pajisjet teknike të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe të verifikueshme modeli me të dhënat e tyre. Pajisjet në pronësi shoqërohen me akt pronësie origjinal ose fature blerje.

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

ARGUMENTIM MBI MARRËVESHJEN KUADËR :

1. Marrëveshja kuadër do të lidhet me një operator ekonomik, pasi janë të përcaktuara të gjitha kushtet kryesore të tilla si: lista e artikujve, specifikimet teknike, si dhe sasi të që pritet të furnizohen.
2. Nga përvoja e prokurimit të artikujve (objekt i kësaj procedure) në vite, çmimet e tregut kanë rezultuar të jenë të qëndrueshëm dhe nuk ndryshojnë.
3. Në rast se kjo marrëveshje do të lidhej me disa OE, duke parë edhe natyrën e këtyre mallrave që përgjigjen nevojave imediate të AK kjo mund t’i shkaktonte kosto shtesë, pasiguri, dhe vështirësi autoritetit kontraktor, si p.sh. mospërputhje të artikujve të dhënë në bazë të rendit, pjesë të tyre të përbashkëta.

Afati i marrëveshjes kuadër do të jetë 12 (dymbëdhjetë) muaj nga nënshkrimi i marrëveshjes kuadër.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

KUSHTET PER TU ZBATUAR NE PRANIM.

A. Në fazën e pranimit, janë të detyruar të paraqesin;

- **Dokumente origjinale** ose të njëvlefshme, të deklaruara në institucionet tona zyrtare, me anë të të cilave të demonstron, se shërbimet janë kryer Referuar ANEX-I me ato të paraqitura në dokumentet e ofertimit.

- **Dokumente origjinale** ose te njevlefshme, te deklaruar ne institucionet tona zyrtare, me ane te te cilave te demonstohet produktet e ofruara

B. Në fazën e zbatimit :

- Operatori ekonomik fitues duhet të **garantojë shërbimin përgjatë 24/7 orëve/dite** perfshire ditet festive dhe pushimi brenda 2 (dy) orëve nga kërkesa për ndërhyrje, dhe të realizojë riparimin brenda një afati maksimal prej 1 (nje) ditësh kalendarike.
- Pas çdo shërbimi të kryer, operatori ekonomik është i **detyruar të dorëzojë pranë Autoritetit Portual Durrës një procesverbal/dokument zyrtar mbi shërbimin e kryer**

VERIFIKIMI DOKUMENTEVE TE DOREZUARA

AUTORITETI KONTRATOR, rezervon te drejten të kryeje, të gjitha verifikimet që i konsideron të nevojshme, per tu garantuar mbi vlefshmerine e dokumenteve te kerkuara.

KOMISIONI I PERCAKTIMIT TE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE PERLLOGARITJES SE VLERES SE FONDIT LIMIT

KRYETAR
Adi Cikaj

ANËTAR
Llambi IKONOMI

ANËTAR
Hekuran Koci